

Tiranë

27/09/2022

Kontakt:

Elton Tirana

E-mail:

elton.tirana@studiotirana.com

Cel: +355 699 325 722



Drejtuar : KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4, Tiranë 1007

Në vëmendje të: Z. Ylli Merkaç

***Objekti: Njoftim mbi pamundësinë e kryerjes së misionit të auditimit për
Partinë Komuniste e Shqipërisë***

Të nderuar Zotërinj,

Bazuar në Kontratën nr. Prot. 2336, datë 09/05/2022 lidhur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Liçensuar (Auditues Ligjor) me misionin e auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzimeve për vitin kalendarik 2021 për Partinë Komuniste e Shqipërisë, ju bëjmë me dijeni se asnjë dokumentacion ligjor e financiar i subjektit politik, që të mundësonte auditimin tonë sipas kërkesave të SNA-ve dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me Ligjin 74/2012) nuk është vënë në dispozicion.

Kemi arritur të marrim një përgjigje nga subjekti politik lidhur me kërkesën tonë, bashkangjitur kësaj shkrese, e cila informon se nuk ka përfituar fonde nga KQZ, por nuk kemi siguruar asnjë informacion dhe bashkëpunim tjetër.

Për shkak të kufizimeve të rëndësishme në informacion dhe dokumentacion, nuk na u mundësua marrja e evidencës së auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të kryer misionin e auditimit dhe dhënies së opinionit tonë. Për këtë arsye, ne ju informojmë se nuk mundëm të realizojmë auditimin e Pasqyrave financiare për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Komuniste e Shqipërisë.

Duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj.

Me respekt,

Elton Tirana



PARTIA KOMUNISTE E SHQIPERISE

Tirane me 8.06.2022

TIRANE

ZOTIT ELTON TIRANA

ZYRA E AUDITIMIT E KOMOSIONIT E QENDROR TE ZGJEDHJEVE

TIRANE

Morem njoftimin tuaj pertu derguar informacion lidhr me fondet e perfitu te shpenezuara gjate vitit 2021 nga Partia Komuniste e Shqiperise.

Ju bejme me dije ,se neve si subjekt politik I legalizuar, nuk kemi marre as **fond prej strukturave perkatese , deri me sot.** Neve gjithë aktiviteti e PKS zhvillojme,mbi kontributin qe japin anetaret e saj,si kuotat e partise,aboni gazeten "Zeri I se Veretes" dhe ndonje aktivitet public ,sidomos perkujtim kemi bere sipas programeve te vete PKSH.Mendojme, se **per keto lloj te ardhurash,komisionit zgjedhor . nuk I duhen.** FLM.

Kryetari I Parti Komuniste

